

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË QËNDRA E TRAJTIMIT TË STUDENTAVE
NR.2, TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Qendra e Trajtimit të Studentëve nr.2, Tiranë, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën 01.01.2013 deri 30.06.2014, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 189 datë 26.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 889/8 datë 29.12.2014, dërguar Z. Viron Bezhani, Administrator i Trajtimit të Studentëve nr.2, Tiranë Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i kryer mbi zbatimin e rekomandimeve rezulton se nga 22 (njëzetedy) masa organizative, të rekomanduara, janë realizuar plotësisht 16 (gjashtëmbëdhjetë) masa, 3(tre) masa nuk janë realizuar dhe 3 (tre) masa janë realizuar pjesërisht.

Për këtë do të rekomandojmë:

Shoqëria të marrë masat për zbatimin e plotë të rekomandimeve me qëllim realizimin e (tre) masave organizative të cilat janë në proces dhe për të 3(tre) masat të cilat nuk janë realizuar.

Menjëherë

2. Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës u konstatua se, për periudhën Janar-Tetor të vitit 2013, anëtarët e KM nuk kanë deklaruar me shkrim numrin e pjesmarjes në këshilla, si dhe nuk kanë lidhur kontratë me Administratorin e shoqërisë. KM nuk ka marrë në shqyrtim punën e auditit të brendshëm dhe nuk ka analizuar gjendjen ekonomiko-financiare të shoqërisë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 08.04.2009 të METE, “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në Shoqëritë Anonime Shtetërore”. Me vendimin nr. 2, datë 09.12.2013, Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar dhënien e një shpërblymimi për të gjithë punonjësit, kur rezultati financiar i shoqërisë ka rezultuar me humbje për vitin 2013, në kundërshtim kjo me nenin 8 të Kontratës Kolektive nr. 2100, datë 11.09.2013. Nga Këshilli Mbikëqyrës nuk janë marrë masat e nevojshme për miratimin brenda afateve ligjore të programit ekonomik për vitin 2014. *Për këtë do të rekomandojmë:*

Shoqëria të marrë masa për të miratuar në Këshillin Mbikëqyrës të saj, treguesit e programit ekonomiko-financiar të shoqërisë për vitin 2014.

Menjëherë

-Të merren masa për hartimin dhe miratimin e një strukture ku të përcaktohet numri i punonjësve, duke argumentuar saktë nevojat për personelin.

-Të merret në analizë çdo 3/mujor gjendja ekonomiko-financiare e shoqërisë si dhe gjetjet dhe problemet e ngritura nga Auditimi i brendshëm.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. Nga auditimi i kryer konstatohet se, Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë nuk ka bërë analiza të hollësishme në lidhje me vlerën reale të subvencionit nga buxheti dhe nga organet drejtuese të shoqërisë, nuk është kërkuar në MAS, subvencionimi i rritjes së çmimit të energjisë elektrike dhe të ujit, me qëllim mbulimin e shpenzimeve dhe uljen e humbjeve nga faktorë që nuk lidhen me aktivitetin e shoqërisë. Subvencioni i akorduar nga MAS për vitin 2013, në shumën 84,154,881 lekë, nuk është përdorur për të përballuar shpenzimet (çmimi i energjisë elektrike, ujë etj.), por shoqëria ka likuiduar pagat e punonjësve në shumën prej 72,856,880 lekë, ose në masën 86.56% të subvencionit gjithsej.

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria të marrë masa për të kryer analiza të hollësishme në Këshillin Mbikëqyrës, në lidhje me nevojat reale që ka shoqëria për subvencion nga buxheti i shtetit, me qëllim përballimin e shpenzimeve për zhvillimin e një aktiviteti normal.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4. Nga auditimi i kryer u konstatua se, në programin ekonomik për vitin 2013, janë planifikuar zëra të shpenzimesh të pastudiuar mirë bazuar në nevojat dhe kërkesat e shoqërisë. Janë parashikuar shpenzime për provigione, për nxjerrje jashtë përdorimit dhe shpenzime për amortizimin, ndërsa në raportin vjetor mbi analizën e realizimit të treguesve të programit ekonomik në fund të vitit 2013, të paraqitur në Këshillin Mbikëqyrës, dega e financës nuk ka vendosur të dhëna të sakta dhe reale për disa zëra të shpenzimeve, pasi nuk kanë raportuar shpenzime të realizuara fakt, në krahasim me programin në fillim të vitit.

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria të bëjë një programim të treguesve ekonomik sa më të studiuar, bazuar në nevojat reale, në mënyrë që të përgjigjet kërkesave të saj, për kryerjen një aktiviteti sa më normal dhe me kosto të ulët, me qëllim përmirësimin e shërbimit për akomodimin e studentëve.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5. Konstatohet se në vitin 2013, shoqëria ka tejkalluar numrin mesatar të punonjësve nga 207 persona me një pagë mesatare prej 32,680 lekë të planifikuar, në fakt është realizuar për 225 persona, me tejkallim për 18 persona, me një pagë mesatare më të ulët prej 31,168 lekë. Ndryshimet janë bërë me propozim të administratorit të shoqërisë, me miratim nga Këshilli Mbikëqyrës, por nuk kanë marrë miratim për shtesat e numrit të punonjësve nga MZHETS, si pronar i vetëm i shoqërisë. Tejkallimi i shpenzimeve për shkak të rritjes së numrit mesatar të punonjësve dhe uljen e pagës mesatare, ka dhënë efekte negative në të ardhurat e shoqërisë duke shkaktuar të ardhura të munguara në vlerën 3,755,000 lekë ose në masën 105% krahasuar me programin ekonomik të miratuar për vitin 2013.

- Për vitin 2014, nuk është bërë miratimi i fondit të pagave dhe numrit mesatar të punonjësve nga pronari METE/MZHETS.

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria të marrë masa për të respektuar numrin mesatar të punonjësve, çdo ndryshim i numrit të punonjësve, të pagave dhe pagës mesatare të bëhen me miratim nga Këshilli Mbikëqyrës dhe MZHETS, referuar Udhëzimit nr. 7, datë 24.04.2003, duke ruajtur treguesit e raportit punonjës/student (1/12).

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6. Nga auditimi i kryer konstatohet se, gjatë vitit 2013, shoqëria ka bërë ndryshime në planin e investimeve, pa marrë miratim në Këshillin Mbikëqyrës, në MAS dhe në MZHETS, dega e financës ka likuiduar zëra të investimeve pa pasur fonde të planifikuara në regjistrin e investimeve për vitin 2013

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria të marrë masa për të bashkërenduar punët midis degës së financës dhe degës teknike, me qëllim zbatimin me korrektësi të regjistrit të prokurimeve në përputhje me zërat e investimeve të miratuara në programin ekonomik vjetor. Çdo ndryshim në planin e investimeve të bëhet duke marrë më parë miratimin në Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë, në MAS dhe MZHETS. Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa për të analizuar në mënyrë periodike realizimin e investimeve sipas zërave të miratuar, likuidimin e fondeve për zëra të investimeve të parashikuara në regjistrin vjetor të prokurimeve dhe në programin ekonomik të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7. Nga auditimi i kryer konstatohet se, procedurat ndjekura për hartimin, miratimin e projekt programit ekonomik dhe treguesit ekonomik për vitet 2013 dhe 2014, janë në shkëlqje të afateve dhe procedurave për hartimin, miratimin dhe dërgimin në MZHETS dhe në MAS, veprime këto që bien ndesh me kreu III, pika 3,4,5, të Udhëzimit nr. 315, datë 8.04.2009, “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, dhe me nenin 18, pika 5/a, të Statutit të Shoqërisë të miratuar në Këshillin Mbikëqyrës në datë 25.06.2012.

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria të marrë masa për të zbatuar procedurat për hartimin, dhe miratimin e projekt programit ekonomik dhe të treguesve ekonomik-financiar për aktivitetin e saj, në përputhje me afatet e përcaktuara në Udhëzimit e MZHETS me nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, dhe statutin e shoqërisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

8. Nga auditimi i bilancit kontabël të vitit 2013, u konstatua se, të dhënat financiare që janë gjeneruar nga programi kompjuterik financiar “Alfa”, nuk janë plotësisht të sakta, ka gabime në klasifikimin sipas klasave në llogaritë kontabël, duke mos pasqyruar me vërtetësi gjendjet dhe lëvizjet debitore e kreditore të këtyre llogarive kontabël; Në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të bilancit të vitit 2013, janë pasqyruar në zërin shpenzime për dieta, në shumën 6,813,682 lekë, që në fakt përfaqësojnë shpërblimet e dhëna për punonjësit, për pagesat për ndihmën ekonomike dhe pagat për Këshillin Mbikëqyrës. Pasqyrimi i gabuar i shpenzimeve në këtë zë, ka ardhur si pasojë e regjistrimit të bërë dhe të gjeneruar nga programi kompjuterik “Alfa”.

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria të marrë masa të përditësojë programin “Alfa” me qëllim përsosjen e hedhjes dhe regjistrimit të të dhënave në kontabilitet.

Menjëherë

9. Nga auditimi i kryer konstatohet se, pasqyrimin e të ardhurave nga akomodimi i studentëve shoqëria e njëj sipas arkëttimeve për vit akademik, duke i pasqyruar si të ardhura të gjithë vitit ushtrimor, përfshirë edhe parapagimet e bëra nga studentët për trajtimin e tyre gjatë periudhës Janar - Qershor të vitit të ardhshëm. Të ardhurat nga qiratë e studentëve dhe arkëtimi i tyre bëhet vjetor në momentin e regjistrimit për akomodimin në godina, ndërsa raportimi dhe regjistrimi i tyre, nuk është bërë sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, por janë raportuar si të ardhura të vitit ushtrimor, duke rënë ndesh me SKK nr. 8 “Detyrimi i të ardhurave të konstatuara”.

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria të marrë masa për të pasqyruar të ardhurat nga akomodimi i studentëve në përputhje me SKK nr. 8 “Detyrimi i të ardhurave të konstatuara”, me qëllim pasqyrimin në mënyrë të saktë të ndarjes së të ardhurave sipas periudhave ushtrimore dhe jo sipas vitit akademik.

Brenda vitit 2014

10. Konstatohet se shoqëria nuk ka llogaritur provigjone për llogarinë “Kërkesa të tjera të arkëtueshme”, në shumën 2,525,509 lekë, që përfaqësojnë kërkesat ndaj studentëve për qiratë, arkëtimi i të cilave është i pamundur, pasi përfaqësojnë gjendje debitore të krijuara që nga viti 1991 e në vazhdim deri në vitin 2009.

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria të marrë masa për të provizionuar gjendjet në llogarinë “Kërkesa të tjera të arkëtueshme”, në shumën 2,525,509 lekë, me miratim të Këshillit Mbikëqyrës, pasi janë detyrime të krijuara që nga viti 1991, e në vazhdim dhe nuk kanë shpresë arkëtimi.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

11. Shoqëria edhe pse është shoqëri aksionare, e cila realizon të ardhura nga dhënia me qira e ambienteve si edhe nga akomodimi i studentëve, konstatohet se nuk aplikon fatura tatimore për shërbimet që kryen.

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria të marrë masa në të ardhmen për të aplikuar fatura tatimore për shërbimin që kryhen për studentët që regjistrohen me qira në godinat e saj, në përputhje me legjislacionin fiskal.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

12. Nga auditimi i kryer u konstatua se, janë pasqyruar si Aktive Afatgjata Materiale, në llogarinë “Ndërtime në proces” në shumën 374,855,914 lekë, e cila përfaqëson vlerën e truallit të shoqërisë dhe jo vlerat për ndërtime në proces. Pasaktësia në pasqyrimin e AAM, ka ardhur si pasojë e instalimit që në vitin 2004, të programit financiar “Alfa”, që ka gjenëruar të dhëna jo të sakta, dhe regjistrimeve të veprimeve kontabël, të cilat janë bërë jo në përputhje me emërtimet dhe klasifikimin e llogarive kontabël.

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria të marrë masa të menjëhershme për të pasqyruar llogaritë kontabël në përputhje me SKK. Për këtë dega e financës të marrë masa për të sistemuar veprimet në kontabilitet për

llogarinë “Ndërtim në proces”, duke e klasifikuar sipas natyrës së AAM me vlerën e trojeve që disponon shoqëria.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

13. Konstatohet se shoqëria në fund të vitit 2013, rezulton me detyrime të pagueshme ndaj furnitorëve, në shumën 11,095,105 lekë, që përfaqësojnë detyrimet e shoqërisë të papaguara ndaj furnitorëve, kryesisht detyrime të trashëguara në vite për energji elektrike ndaj CEZ, për ujin ndaj UKT-së, etj.

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria të marrë masa të menjëhershme për të likuiduar të gjitha detyrimet që ka ndaj furnitorëve të krijuara në vite dhe gjatë vitit 2013, për blerje mallrash dhe për shërbime të ndryshme.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

14. Nga auditimi i kryer konstatohet se shoqëria rezulton në fund të vitit 2013, me gjendje në llogarinë parapagime të arkëtueshme, në shumën 4,682,000 lekë, që përfaqëson siguracionet e arkëtuara nga 2341 studentë të regjistruar për vitin 2013. Në mbarim të vitit akademik 2013-2014, nga dega e financës nuk janë kryer veprimet për të kthyer siguracionin studentëve, por janë mbajtur gjendje në bankë, duke nxjerrë shoqërinë debitore ndaj 2341 studentëve. Ky veprim bie ndesh me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Për këtë rekomandojmë:

Dega e financës dhe dega teknike e shoqërisë të marrin masa për të llogaritur, vlerësuar dhe dokumentuar vlerat e dëmit të shkaktuar nga studentët në dhomat përkatëse për vitin 2013. Bazuar në urdhërat e zhëmtimit të administratorit të shoqërisë, dega e financës të bëjë ndalesat për studentët që duhet të zhëmtojnë, ndërsa për të studentët e tjerë të kthehet vlera e siguracionit të mbajtur gjendje në llogaritë e bankës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

15. Konstatohet se shoqëria nuk ka llogaritur provigjone për llogaritë e arkëtueshme afatshkurtra, “Të drejta dhe detyrime për zhëmtim” në shumën 4, 658, 054 lekë, arkëtimi i të cilave është i pa mundur.

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria dhe Këshilli Mbikëqyrës të marrin masa për të miratuar provizionimin e shumës 4,658,054 lekë, pasi janë detyrime të krijuara para shumë vitesh dhe arkëtimi i tyre është i pamundur.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

16. Konstatohet se shoqëria në fund të vitit 2013, rezulton me gjendje në llogarinë “Rimarrje subvencionesh”, në shumën 1,396,846 lekë, që përfaqëson vlera të parashikuara për rreziqe të tjera të kontabilizuara që para vitit 2005, të cilat kontabilizohen të njëjtat vlera prej vitesh pa ndryshime. Dega e financës nuk disponon dokumente për origjinën e veprimit kontabël, për pasojë regjistrimet në këtë llogari bëhen pa bërë një analizë financiare, me qëllim sistemimin e shumës së trashëguar prej 9 vitesh.

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria me miratim të Këshillit Mbikëqyrës, të marrë masa për të provizionuar shumën 1,396,846 lekë, për vlerën e një rimarrje subvencionesh që nga viti 2005, duke e kaluar në të ardhurat e shoqërisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

17. Konstatohet se, gjatë vitit 2013, shoqëria nuk ka pasur një mirë menaxhim të mjeteve monetare përkohësisht të lira për arsye se, në fund të vitit ushtrimor shoqëria rezulton me gjendje në bankë në shuma të mëdha, ka blerë dhe mban materiale në magazinë duke bllokuar fondet, nuk ka mbledhur detyrimet nga klientët për shërbimet e ofruara, si dhe nuk ka shlyer detyrimet që ka ndaj furnitorëve dhe kreditorëve të tjerë në vite. Këto veprime bien ndesh me nenin 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, me ligjin 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Nga viti në vit rezulton se aktiviteti i shoqërisë megjithëse subvencionohet nga buxheti i shtetit, është me humbje, për arsye se nuk realizon të ardhurat nga aktiviteti i saj.

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria dhe Këshilli Mbikëqyrës të bëjnë analiza të hollësishme me të gjithë degët dhe sektorët, për mirë menaxhimin e mjeteve monetare të saj me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet, me qëllim rritjen e të ardhurave për të ulur humbjen nga aktiviteti kryesor, si dhe likuidimin e detyrime ndaj debitorëve dhe kreditorëve të ndryshëm .

Menjëherë dhe në vazhdimësi

18. Konstatohet se shoqëria, nuk ka përfunduar plotësisht procedurat ligjore për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të shoqërisë pranë Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Tiranë.

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria të marrë masa për të përfunduar procesin e regjistrimit të trojeve, që i përket regjistrimit të godinës nr. 1, mjekësi në pronësi të saj, si dhe të bëjë pagesat e taksave vendore që priten të bëhen nga rivlerësimi i tyre nga Bashkia.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

19. Konstatohet se në bilancin vitit 2013, rezulton me gjendje llogarie “Grande dhe të ardhura të shtyra”, në shumën 72,278,992 lekë, që përfaqëson rimarrje si e ardhur nga amortizimi i fondit për subvencion për investime të kryera para vitit 2007, investim ky i pakësuar në vlerë duke kaluar si e ardhur në masën 5% të vlerës fillestare çdo vit. Ky veprim kontabël do vazhdojë të kryhet për shumë vite të tjera, deri sa shuma nga rimarrja e investimit të kryer që nga vitit 2007 të rezultojë në këtë llogari me gjendje zero.

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria dhe Këshilli Mbikëqyrës të bëjnë analiza analitike për këtë llogari të krijuar që nga viti 2007, me qëllim për të provizionuar vlerën e mbetur në shumën 72,278,992 lekë, për grande dhe të ardhura të shtyra, (të trashëguara që nga viti 2007), dhe të kalojnë në të ardhura të shoqërisë, me qëllim përmirësimin e situatës së vështirë financiare, duke ndikuar drejtpërdrejtë në të ardhurat e vitit ushtrimor .

Menjëherë dhe në vazhdimësi

20. Për periudhën e audituar, kërkesat për prokurim mallra e shërbime nga degët, nuk janë bashkëlidhur praktikave të bankës për likuidimin e prokurimeve me vlera të vogla, si edhe për realizimin e blerjeve me vlera të vogla nuk ka kërkesa të argumentuara për domosdoshmërinë e prokurimeve nga degët, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe me Udhëzimet e Ministrit të Financave, nr. 92, datë 29.12.2011 dhe 33, datë 11.07.2013.

-Procedurat për prokurimet me vlera të vogla për vitin 2013, vetëm në 4 raste janë kryer në sistemin elektronik.

-Kërkesat dhe preventivat nuk kanë të specifikuara specifikimet teknike përkatëse, ose edhe në rastet kur janë bashkëlidhur specifikimet për mallra e shërbime, ato nuk janë nënshkruar nga hartuesit e tyre, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”.

Për këtë rekomandojmë:

-Drejtoria e shoqërisë të marrë masa për trajnimin e stafit që merret me prokurimet, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në lidhje me përcaktimin e fondit limit, përcaktimin e nevojave, specifikimeve teknike, etj, deri në realizimin e plotë të prokurimit.

- Bazuar në Udhëzimin e MZHETS nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror” dhe VKM nr 1 date 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, në kërkesat për mallra e shërbime të parashikuara nga shoqëria, në Regjistrin e Parashikimit të Prokurimeve Publike, treguesit e planifikuar të pasqyrojnë nevojat dhe kërkesat reale të tyre, duke u nisur edhe nga gjendja financiare e Shoqërisë.

-Strukturat dhe personat përgjegjës në autoritetin kontraktor, duhet të forcojnë kontrollin e brendshëm në lidhje me procedurat e programimit dhe prokurimit, si për parashikimin e nevojës për prokurim, kërkesës dhe miratimin e saj edhe për hartimin sa më të saktë të specifikimeve teknike.

-Specifikimet teknike të shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar standardeve kombëtare e ndërkombëtare për prodhimin e mallrave dhe të hartohen sa më saktë të lidhura me objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të operatorëve ekonomikë në zbatim të parimeve bazë të prokurimit, barazia dhe konkurrenca.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

21. U konstatua se, komisionet e prokurimeve me vlera të vogla, kanë zbatuar procedurat e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik, por nuk ka gjurmë auditimi se si është vepruar me përcaktimin e çmimeve në një kohë që nuk ka specifikime të qarta për artikujt që do të prokurohen.

-Fondi limit i parashikuar për prokurimet me vlerë të vogël, është përcaktuar prej 480 mijë lekë, deri në kufirin maksimal ligjor të lejuar për këtë prokurim, veprime të cilat tregojnë se Autoriteti Kontraktor, nuk ka analizuar e llogaritur fondin sipas nevojave, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, Për prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 315 datë 08.04.2009 e METE “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të Shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”.

Për këtë rekomandojmë:

-Drejtoria e shoqërisë të marrë masa për të bërë argumentimin e fondit limit për blerjet me vlerë të vogël nga komisioni i ngritur me urdhër të degës përkatëse, në të cilin duhet të përfshihen specialistë të fushës në vlerësim dhe për përcaktimin e specifikimeve teknike.

-Të dokumentohet procedura e ndjekur duke lënë gjurmë, me qëllim që të ketë një vlerësim real të nevojës për mallra, punime apo shërbime.

--Të bëhet argumentimi i fondit limit për mallra apo shërbime, bazuar në gjendjen e mallrave në magazinë, në testimin e tregut dhe ofertat e operatorëve ekonomikë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

22. Konstatohet se, nëpërmjet arkës, janë kryer pagesa për prokurim mallra, shërbime dhe punë për periudhën objekt auditimi në 64 raste në shumën 535,747 lekë, të cilat nuk kanë bashkëlidhur kuponin tatimor si dokument justifikues, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 54 “kuponi tatimor”.

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria të marrë masa për minimizimin e shpenzimeve nëpërmjet arkës si dhe të respektojë kryerjen e veprimeve brenda limitit të përcaktuar të arkës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

23. U Konstatua se, shoqëria për periudhën objekt auditimi janë bërë largime të shumta nga puna, për të cilat janë hapur 59 çështje gjyqësore. Bazuar në vendimet e gjykatës shuma e kërkuar nga këta punonjës është **53,894,652 lekë**, vlerë e cila ndikon drejtpërdrejtë në të ardhurat e shoqërisë, duke krijuar efekte negative financiare.

-Marrëdhëniet e punës me punonjësit janë ndërprerë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

-Dega e Burimeve Njerëzore nuk ka kryer procedura të rregullta ligjore për zgjidhjen e kontratës së punës konform kërkesave të nenit 143, pika 1, i Kodit të Punës, si dhe nenet 143, 144, 153 pika 8.2 për “Procedurat disiplinore”, “Afatet e njoftimit” pika 10 “Përfundimi i marrëdhënieve të punës”.

-Struktura Organizative e shoqërisë nuk reflekton qartë arsimin përkatës me pozicionin e punës duke lënë hapësira për interpretim, dhe në disa raste ka mos përputhje të nivelit arsimor me pozicionin e punës.

-Për rekrutimin e stafit shoqëria nuk ka përcaktuar kritere dhe nuk ka ndjekur procedura si, intervista, testim, etj. Për çdo pozicion pune, nuk zbatohen kriteret të përputhjes së nivelit arsimor përkatës dhe eksperiencën në punë, si edhe nuk ka gjurmë në asnjë rast për nevojat e degëve të shoqërisë në lidhje me zëvendësim apo rekrutim punonjësve të rinj.

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria të marrë masa që lëvizjet e personelit të bëhen bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

-Rregullorja e brendshme dhe struktura e shoqërisë duhet të pasqyrojë kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

-Në strukturën organizative të shoqërisë të përcaktohen kritere të qarta mbi arsimin përkatës për çdo pozicion pune, me qëllim që të ketë përputhje të nivelit arsimor me pozicionin e punës, për rekrutimin e stafit dhe eksperiencën në punë, dhe të lihen gjurmë me dokumentacion për nevojat e degëve lidhur me zëvendësim apo rekrutimin e punonjësve të rinj.

- Të përcaktohet një rregullore në përzgjedhjen e stafit . Procesi për përzgjedhjen të bazohet në vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve nëpërmjet një konkurrimi, që përfshin një testim të shkruar, një testim me gojë dhe çdo formë tjetër të përshtatshme të verifikimit të aftësive, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatit sipas pozicionit të punës. Të gjitha proceset të jenë të dokumentuara dhe të lënë gjurmë në përzgjedhjen e kandidatit.

-Shoqëria të marrë masa për të zbatuar vendimet gjyqësore të formës së prerë, për punonjësit që janë larguar padrejtësisht nga puna.

- Këshilli Mbikëqyrës, të marrë në analizë të gjitha lëvizjet dhe largimet nga puna të punonjësve, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë ligjore për personat përgjegjës, të cilët kanë larguar padrejtësisht punonjësit nga puna.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

24. Nga auditimi i dosjeve të personelit u konstatua se, ato nuk janë të inventarizuara në përputhje me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

-Dosjet e personelit nuk janë të plotësuara me dokumentacion individual, si: certifikate, cv, raporte mjekësore, diploma etj, kjo në kundërshtim me rregulloren e brendshme të shoqërisë.

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria të marrë masa për të bërë inventarizimin e dosjeve të personeli në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, si dhe plotësimin e tyre me dokumentacionin përkatës të përcaktuar dhe në rregulloren e brendshme të shoqërisë

Menjëherë dhe në vazhdimësi

25. Konstatohet se, shoqëria nuk ka ndjekur të gjitha hapat për të vënë në zbatim ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria të marrë masat për të ngritur një grup pune, me qëllim ndjekjen e të gjitha hapave për vënien në zbatim të detyrimeve të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

26. Konstatohet se Auditimi i Brendshëm ka miratuar programet vjetore në Këshillin Mbikëqyrës, ka realizuar auditimet e programuara e raportuar çdo tremujor në drejtorinë e shoqërisë dhe në këshillin mbikëqyrës, por në asnjë rast nuk është rekomanduar masë disiplinore.

Për këtë rekomandojmë:

Auditimi i Brendshëm të marrë masa për rastet që konstatohen me shkelje të rekomandojnë masa disiplinore për personat përgjegjës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

27. Nga auditimi i procesit të ndjekur për inventarizimin e aseteve të shoqërisë, konstatohet se nuk janë ndjekur procedurat për nxjerrjen në ankand të materialeve të vlerësuara nga komisioni i rivlerësimi nga inventarizimi i aseteve të kryer në vitin 2012, për shitjen e materialeve për skrap në vlerën kontabël 983,475 lekë, të cilat janë në ruajtje në magazinën rikupero; dega e finances ka kryer veprime për shkarkimin e vlerave në kontabilitet të materialeve të destinuara për tu shitur për skrap; nuk janë marrë masa për të kryer procedurat në zbatim të ligjit nr.9874, datë

14.02.2008 “Për ankandin publik” dhe VKM nr.1719, datë 14.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”.

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria të marrë masa për të kryer procedurat e ankandit për materialet për skrap në vlerën 983,475 lekë, në zbatim të ligjit nr.9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik” dhe VKM nr.1719, datë 14.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”. Dega e financës të kryejë veprimet kontabël të risistemimit të shumës 983,475 lekë, për materialet jashtë përdorimit të destinuara për skrap, duke i bërë hyrje në magazinë, deri sa të kryhen procedurat e ankandit, në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

28. Nga auditimi i kryer u konstatua se, nuk është përfunduar procesi i inventarizimit të asetëve të shoqërisë për vitin 2013, si dhe nuk janë kryer veprimet në kontabilitet për rezultatet e inventarit, pasi nga ana e kryetares së degës së financës nuk është paraqitur relacion në Këshillin Mbikqyrës për të miratuar materialet jashtë përdorimit, me vlerë fillestare 664,000 lekë, dhe në vlerën neto për 293,099 lekë. Po kështu, nga ana e administratorit të shoqërisë nuk ka dalë urdhëri për krijimin e komisionit për asgjësimin e materialeve jashtë përdorimit, dhe nuk janë kryer procedurat për miratimin e AQT jashtë përdorimit nga MZHETS, duke rënë ndesh me nenin 7, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë, të nxjerrë urdhërin për ngritjen e komisionit për asgjësimin e materialeve jashtë përdorimit të rezultuar nga inventarizimi i asetëve për vitin 2013. Në përfundim të këtij procesi Këshilli Mbikqyrës të miratojë rezultatet e inventarizimit për materialet jashtë përdorimit në shumën 73,385 lekë, duke marrë miratimin për vlerat e AQT-ve jashtë përdorimit në MZHETS.

Deri në datë 31.12.2014

29. Nga auditimi i kryer u konstatua se, për vitin 2013, bazuar në kontratat e lidhura me studentët për strehimin e tyre në godina, janë strehuar 2343 studentë, nga 2366 studentë të planifikuar për strehim, pra janë regjistruar 23 studentë më pak, për pasojë janë vjelë të ardhura më pak nga shfrytëzimi i bujtinave për strehimin e studentëve në vlerën 966,000 lekë, me efekte negative si të ardhura të munguara në rezultatin financiar të shoqërisë për vitin 2013.

Për këtë rekomandojmë:

Shoqëria të marrë masa për të analizuar punën e degës hoteleri dhe lavanderi, me qëllim bërjen e marketingut për përmirësimin e kushteve për strehimin e studentëve për rritjen e numrit të studentëve dhe realizimin e të ardhurave nga akomodimi i studentëve.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

30. Qiramarrësit nuk kanë lidhur kontratat me Ujësjellës Kanalizime SHA, Tiranë dhe CEZ Shpërndarje, deri në muajin gusht të vitit 2013, detyrim i përcaktuar në nenin 10.3 të kontratave respektive, këto shpenzime janë përballuar nga Shoqëria “Trajtimi Studentëve nr. 2“ SHA

Tiranë. Po kështu konstatohet se 2 prej qiramarrësve ende nuk kanë nënshkruar kontratat me CEZ Shpërndarjen.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria të marrë masat e nevojshme dhe të zbatojë procedurat ligjore për lidhjen e kontratave me Ujësjetës Kanalizime SHA, Tiranë dhe OSHEE, për 2 qiramarrësit, [REDAKTUAR] për dhënie ambient me qira me sipërfaqe 18.5 m2 në Godinën nr. 3 dhe 4 Ing, me destinacion “Tregtim artikuj kancelarie dhe minimarket” dhe [REDAKTUAR] për dhënie ambient me qira me sipërfaqe 14.3 m2 në godinën 2 Mjekësi me destinacion “Tregtim artikuj kancelarie dhe minimarket”, detyrim i përcaktuar në nenin 10.3 të kontratave respektive.

-Drejtoria të marrë masat e nevojshme për të kryer monitorimin e plotë dhe të vazhdueshëm të kontratave të dhënies me qira të objekteve.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

31. Konstatohet se në kontratën e nënshkruar nga shoqëria me kompaninë celulare “[REDAKTUAR]”, është përcaktuar në nenin 3/c “Detyrimet e Pajtimtarit”, që pagesa e detyrimit në vlerën fikse mujore të bëhet nga pajtimtari (shoqëria) dhe jo nga secili punonjës i shoqërisë që disponon numër celular sipas kësaj marrëveshje. Për punonjësit e larguar nga puna nga kjo shoqëri, nuk janë kryer ndalesat nga paga mujore, në kundërshtim me Udhëzimin 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”.

Për këtë rekomandojmë:

Strukturat drejtuese të shoqërisë të marrin masa për amendimin e kontratës së nënshkruar me kompaninë “[REDAKTUAR]” të nenit 3/c “Detyrimet e Pajtimtarit”, në të cilin të përcaktohet se vlera e pagesës fikse mujore, nuk do të kryhet nga pajtimtari, por nga secili punonjës pranë kësaj kompanie që ka në dispozicion numër celulari sipas kësaj marrëveshje

Menjëherë

32. Shoqëria të marrë masa për zj [REDAKTUAR] për ta kthyer në vendin e saj të mëparshëm të punës, ose në një vend pune tjetër paralel.

Menjëherë

B. MASA ZHDËMTIMI

1. Konstatohet se, nuk është shlyer detyrimi në shumën **1,080,056 lekë**, për 3 kontratat e nënshkruara me kompanitë celulare nga shoqëria, detyrim i faturuar ndaj shoqërisë nga kompanitë celulare për të cilin nuk është kryer ndalesa punonjësve nga paga mujore nga dega e financës, në kundërshtim me Udhëzimin 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”.

Për këtë rekomandojmë:

Strukturat drejtuese të shoqërisë të marrin masa për ndjekjen dhe arkëtimin në rrugë ligjore të detyrimeve nga punonjësit të shumës 1,080,056 lekë, përfutuar padrejtësisht nga shërbimi i telefonisë celulare.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në nenin nr.37, të Kodit të Punës, dhe në kontratën kolektive, me nr.2100, datë 11.09.2013, neni 21 “Masat disiplinore”, kërkojmë nga Administratori i shoqërisë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra”

1.z. ■■■■■ me detyrë Kryetar i degës së financës, për arsye se:

- Nuk ka raportuar të ardhurat nga qiratë e studentëve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, por i ka raportuar si të ardhura të vitit ushtrimor, në kundërshtim me SKK nr.8 “Të ardhurat”, por i ka regjistruar si arkëtime në momentin regjistrimit të studentëve për akomodimin e tyre në godina,
- Ka parashikuar në programin ekonomik zëra të shpenzimeve si për provigjone, shpenzime për nxjerrje jashtë përdorimit dhe shpenzime për amortizimin, shpenzime të cilat nuk i ka parashikuar paraprakisht në programin ekonomik .
- Nuk ka ndjekur afatet dhe procedurat për hartimin, miratimin e projekt programit ekonomik dhe miratimin e treguesve ekonomik e financiar të shoqërisë për vitin 2014, dhe nuk ka dërguar në kohë në MZHETS dhe në MAS, veprime këto që bien ndesh me kreun III, pikat 3, 4, 5, të Udhëzimit nr. 315, datë 8.04.2009, “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, raportuar në fakt se sa janë realizuar.
- Janë konstatuar gabime në klasifikimin e llogarive sipas klasave në bilancin kontabël të vitit 2013, pasi të dhënat që ka gjeneruar programi Alfa, nuk kanë qenë plotësisht të sakta, për pasojë nuk janë pasqyruar me vërtetësi gjendja dhe lëvizjet debitorë e kreditorë të llogarive kontabël.
- Nuk ka bërë evidentimi dhe raportimi i të ardhurave të realizuara nga pagesat e studentëve sipas periudhave ushtrimore, por pasqyrimi i të ardhurave nga akomodimi i studentëve, duke mos gjetur zbatim parimi i të drejtave të konstatuara, por si të ardhura sipas arkëtimeve për vitin akademik, veprime këto që bien ndesh me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, nr. 8, ku përcaktohet se “...Të ardhurat do të njihen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme”.
- Në mbarim të vitit akademik 2013-2014, nuk janë kryer veprimet për të kthyer figuracionin studentëve, por janë mbajtur gjendje në llogarinë si parapagime të arkëtueshme, duke nxjerrë shoqërinë debitorë ndaj 2341 studentëve. Ky veprim bie ndesh me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.
- Ka lejuar të tejkalohen shpenzimet për shkak të rritjes së numrit mesatar të punonjësve dhe ulja e pagës mesatare, të cilat kanë dhënë efekte negative në të ardhurat duke shkaktuar të ardhura të munguara në shumën 588,240 lekë, në të ardhurat e shoqërisë për vitin 2013.
- Nuk ka marrë miratimin në MZHETS, për tejkalimin e numrit mesatar të punonjësve për vitin 2013, në kundërshtim me statutin e shoqërisë, neni 18, pika 5/a, dhe me udhëzimin nr. 318, datë 8.04.2009, i METE/MZHETS, pika 5.
- Ka kryer likuidimet ndaj kompanisë celulare ■■■■■ pa u nënshkruar kontrata midis palëve, në kundërshtim me Udhëzimin 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre” ku citohet se

“regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në *dokumente autorizues* të cilët autorizojnë kryerjen e veprimit të caktuar ekonomik dhe që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Të tillë janë urdhrat e blerjeve, *kontratat*, urdhrat për krijimin e komisioneve, etj.

- Nuk ka marrë masa për ndjekjen e detyrimeve debitore të krijuara nga shpenzimet telefonike faturuar nga kompanitë celulare në shumën *1,080,056 lekë*.

- Nuk ka ndjekur e zbatuar procedurat ligjore për prokurimet me vlerë të vogël, si: për prokurimin me objekt *“blerje stola për sallat e studimit”* në shumën 321,600 lekë, në procedurën e prokurimit me vlera të vogla me objekt *“blerje tonera”* në shumën 377,760 lekë, kërkesa për blerjen, argumentimin e fondit dhe ofertat datojnë më parë se urdhri i titullarit. Ka lejuar nënshkrimin e faturave të shitësit nga magazinieri dhe jo nga 2 prej antarëve të komisionit të blerjeve, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik” Kreu VI pika 2/ç.

- Ka kryer procedura prokurimi me vlera të vogla pa u përcaktuar specifikimet teknike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”.

2. zj [REDACTED] kryetare e degës së burimeve njerëzore, për arsye se:

- Në procedurën e prokurimit me vlera të vogla me objekt *“blerje artikuj ushqimorë”* në shumën 98,680 lekë, ka hartuar kërkesa pa përcaktuar destinacionin, pa argumentuar nevojat, sasitë, specifikimet, etj, ka përcaktuar në kërkesën për prokurim edhe komisionin për llogaritjen e fondit.

- Në procedurën e prokurimit me vlera të vogla me objekt *“blerje artikuj kancelarie”* në shumën 253,153lekë, ka hartuar kërkesa pa përcaktuar destinacionin, pa argumentuar nevojat, sasitë, specifikimet, etj, ka përcaktuar në kërkesën për prokurim edhe komisionin për llogaritjen e fondit.

- Në procedurën e prokurimit me vlera të vogla me objekt *“blerje tonera”* në shumën 377,760 lekë, ka hartuar kërkesa pa përcaktuar destinacionin, pa argumentuar nevojat, sasitë, specifikimet, etj, ka përcaktuar në kërkesën për prokurim edhe komisionin për llogaritjen e fondit, e cila daton më parë se urdhri i titullarit.

Mos hartimi i kërkesave nga degët apo zyrat përkatëse, hartimi i kërkesave pa përcaktuar objektin dhe destinacionin, mungesa e kërkesave, si edhe kërkesa të pa studiuar, janë veprime në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VI “Zhvillimi i procedurës së kërkesës për propozime, prokurim me vlerë të vogla, shërbimet e konsulencës, konkursi i projektimit”, pika 2, “Prokurim me vlerë të vogël”, nënpika “b”, ku është përcaktuar se: “Kur lind nevoja për punë, mallra ose shërbime, titullari i autoritetit kontraktor ose një zyrtar tjetër i autorizuar, lëshon një urdhër, ku përcaktohen natyra dhe sasia e tyre”.

Gjithashtu sa më sipër është në kundërshtim edhe me Udhëzimet e Ministrit të Financave, nr. 92, datë 29.12.2011 dhe 33, datë 11.07.2013, ku është përcaktuar se: “Kërkuesi i shërbimit bën kërkesë për prokurime me vlerë të vogël brenda limitit të përcaktuar nga ligji së bashku me specifikimet teknike, kriteret për përzgjedhjen e fituesit, afatin kohor për dorëzimin e propozimeve dhe kushtet kryesore të kontratës”.

- Nuk ka zbatuar numrin mesatar të punonjësve duke e rritur atë me 18 punonjës më shume dhe duke tejkaluar fondin e pagave për vitin 2013 në shumën 3,755,000 lekë, shumë e cila përbën efekt negativ në rezultatit financiar të shoqërisë.
- Nuk ka ndjekur procedurat e rregullta ligjore për zgjidhjen e kontratës së punës konform kërkesave të nenit 143, pika 1 i Kodit të Punës, si dhe nenet 143, 144, 153 pika 8.2 për “Procedurat disiplinore”, “Afatet e njoftimit”, pika 10 “Përfundimi i marrëdhënieve të punës” duke shkaktuar një efekt negativ financiar për shoqërinë në vlerën 53,894,652 lekë, shumë e kërkuar nga punonjësit e larguar nga puna nëpërmjet proceseve gjyqësore.
- Nuk ka plotësuar dosjet e punonjësve me dokumentacion individual, si: certifikate, cv, raporte mjekësore, diploma etj, kjo në kundërshtim me rregulloren e brendshme të shoqërisë.
- Nuk ka inventar të dokumentacionit në dosjet e personelit konform Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”. Shkresat në brendësi të dosjeve janë të hartuara në mënyrë jo korrekte dhe zyrtare.

“Vërejtje me paralajmërim”.

1. zj [REDACTED] specialiste në degën e burimeve njerëzore, për arsye se:

- Në procedurën e prokurimit me vlera të vogla me objekt “blerje tonera” në shumën 377,760 lekë, nuk ka argumentuar fondin limit, por ka caktuar vlerën limit të lejuar pa u përcaktuar specifikimet teknike, nuk ka lënë gjurmë për mënyrën e marrjes së ofertave, ka vepruar më parë se të dalë urdhri nga Administratori, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike” dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. zj [REDACTED] kryetar i degës teknike, për arsye se :

- Nuk ka miratuar ndryshimet e bëra në planin e investimeve për vitin 2013, pasi ka pasur ndryshime në disa zëra të investimeve pa marrë miratimin nga MAS dhe MZHETS. Janë kryer procedura për zëra të investimeve pa pasur fonde të planifikuara në regjistrin e investimeve, pasi nuk janë programuar fonde në programin ekonomik të vitit 2013.

“Vërejtje”

1. zj [REDACTED] specialiste marketingu, në cilësinë e anëtares së komisionit për llogaritjen e fondit limit, për arsye se:

- Në procedurën e prokurimit me vlera të vogla me objekt “blerje artikuj kancelarie” në shumën 253,153 lekë, nuk ka argumentuar fondin limit, por ka caktuar vlerën limit të lejuar pa u përcaktuar specifikimet teknike, nuk ka lënë gjurmë për mënyrën e marrjes së ofertave, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike” dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. zj [REDACTED] specialiste marketingu, për arsye se:

- Në procedurën e prokurimit me vlera të vogla me objekt “blerje tonera” në shumën 377,760 lekë, nuk ka argumentuar fondin limit, por ka caktuar vlerën limit të lejuar pa u përcaktuar specifikimet teknike, nuk ka lënë gjurmë për mënyrën e marrjes së ofertave, ka vepruar më parë se të dalë urdhri nga Administratori, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

- Në procedurën e prokurimit me vlera të vogla me objekt “blerje artikuj kancelarie” në shumën 253,153 lekë, nuk ka argumentuar fondin limit, por ka caktuar vlerën limit të lejuar pa u përcaktuar specifikimet teknike, nuk ka lënë gjurmë për mënyrën e marrjes së ofertave, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike” dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

3. z. [REDAKTUAR] specialiste marketingu, për arsye se:

- Në procedurën e prokurimit me vlera të vogla me objekt “blerje tonera” në shumën 377,760 lekë, nuk ka argumentuar fondin limit, por ka caktuar vlerën limit të lejuar pa u përcaktuar specifikimet teknike, nuk ka lënë gjurmë për mënyrën e marrjes së ofertave, ka vepruar më parë se të dalë urdhri nga Administratori, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike” dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

- Në procedurën e prokurimit me vlera të vogla me objekt “blerje artikuj kancelarie” në shumën 253,153 lekë, nuk ka argumentuar fondin limit, por ka caktuar vlerën limit të lejuar pa u përcaktuar specifikimet teknike, nuk ka lënë gjurmë për mënyrën e marrjes së ofertave, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike” dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

4. z. [REDAKTUAR] përgjegjës sektori i hotelerisë, për arsyes se:

- Në procedurën e prokurimit me vlera të vogla me objekt “blerje stola për sallat e studimit” në shumën 321,600 lekë, nuk ka argumentuar fondin limit, por ka caktuar vlerën limit të lejuar pa u përcaktuar specifikimet teknike, si dhe më parë ka dalë shkresa për argumentimin e fondit dhe marrja e ofertave se sa urdhëri I titullarit për nevojën e kryerjes së prokurimit, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Shënim : Do rekomandonim masa disiplinore, për, ish-administratorin e shoqërisë z. [REDAKTUAR] z. [REDAKTUAR] ish-administratror, z. [REDAKTUAR] ish-kryetar i degës të burimeve njerëzore, ish-anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, [REDAKTUAR] zj. [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] zj. [REDAKTUAR] ish-juriste në degën juridike, zj. [REDAKTUAR] ish-llogaritar e parë në degën e financës, zj. [REDAKTUAR] ish zv/drejtoreshe e shoqërisë, z. [REDAKTUAR] ish-kryetar i degës teknike, z. [REDAKTUAR] ish-kryetar i degës së hotelerisë dhe zj. [REDAKTUAR] ish-nëndrejtoreshë e shoqërisë, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, do të rekomandonim masat disiplinore “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”, por meqenëse këta persona janë larguar nga detyra që kanë mbajtur për periudhën nga viti 2013 deri në qershor të vitit 2014 në “Trajtimi i Studentëve nr. 2, SHA, Tiranë, masat disiplinore konsiderohen të ezauruara.

Në vijim do të njoftohet Drejtoria e Administratës Publike për personat e lartpërmendur.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Luljeta Shtylla, Lavdie Fshazi, Migena Nushi, Elira Kola Valentina Sulo më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Standarteve Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Sekretari i Përgjithshëm Luljeta Nano.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT